

RS. $\frac{7}{13.27}$

BULETINI
I SHKENCAVE
GJEOLOGJIKE

VITI VI (XXIII) I BOTIMIT

4
1987

Tiranë

TREGUESI I LËNDËS

(Contents)

GJEOLGJI

(Geology)

	Faqe
✓ Sh. Aliaj — Disa çështje themelore të evolucionit struktural të zonave të jashtme të Albanideve (On some fundamental aspects of the structural evolution of Outer zones of Albanides)	3 20
✓ A. Kodra — Skema e zhvillimit paleogeografik e gjeotektonik të Albanideve të brendshme gjatë triasikut e jurasikut (Scheme of the paleogeographical and geotectonic development of Inner Albanides during the Triassic and Jurassic)	23

MINERALET E DOBISHME

(Mineral ores)

A. Graždani — Metalogjenia e thyerjeve tërthore të Albanideve (Metallogeny of transversal faults of Albanides)	47
E. Pumo, B. Ostrosi — Marrëdhëniet midis prodhimeve lateritike dhe formacioneve qymyrbajtëse të Albanideve (Les relations entre les produits lateriques et les formations a charbon et lignitiferes d'Albanides)	49 62
S. Laska — Disa dukuri të mineralizimit fosfatik në Antiklinalin e Fterës që hedhin dritë mbi kushtet e sedimentimit të tij (Some phenomena of the phosphatic mineralization in anticline of Ftera, which throw light upon the formation conditions)	65 70

GJEOKIMI — (Geochemistry)

I. Alliu — Veçori litogjeokimike të rajonit Rrafshi Korabit-Presh (Radomirë)	73
--	----

(Lithological — geochemical features of Rrafshi i Korabit-Presh (Radomirë) region)	81
--	----

STRATIGRAFI — PALEONTOLOGJI — (Stratigraphy — Paleontology).

S. Meço — Konodontet e kufirit silurian-devonian në disa prerje të zonës Korabi (Conodonts of the Silurian-Devonian boundary in some section of the Korabi-zone)	83 99
Th. Gjata, P. Theodhori, V. Kici, D. Marku, A. Pirdeni — Stratigrafia dhe kushtet e formimit të depozitimeve jurasike në pjesët periferike të zonës Mirdita (Albanidet Lindore) (Stratigraphy and the formation's conditions of Jurassic deposits of peripheral parts of the Mirdita zone (Eastern Albanides))	101 110
A. Pirdeni — Mikrofaciet dhe foraminiferët bentonikë triasike në Albanide (Microfacies and Triassic benthic foraminifera of Albanides)	113 121

SIZMOLOGJI — (Seismology)

E. Sulstarova — Mekanizmi i vatrave të tërmeteëve në Shqipëri dhe fusha e sforcimeve tektonike të sotme (Mechanism of centres of the earthquakes in Albania and the field of the recent tectonic contractions)	133 169
---	------------

PROBLEME METODIKE — (METHODIC PROBLEMS)

J. Vllaho — Disa aspekte të metodikës së marrjes së provave gjeokimike në rëvizimet llumetrike (Some aspects on the methodics of the collection of geochemical samples by stream sampling plottings)	171 181
A. Thanasi, A. Ğega, — Studimi i metodave të përcaktimit të SiO_2 , BaSO_4 , CaF_2 dhe disa elementëve të tjerë në xeherorët laritik me përzierje fluoriti të Levrushkut (Study of the methods of determination of SiO_2 , BaSO_4 , CaF_2 and some other elements in barite ores with the mixtures of the fluorite of Levrushku)	183 188

Gjeologji

DISA ÇËSHËTJE THEMELORE TË EVOLUCIONIT STRUKTUROR TË ZONAVE TË JASHTME TË ALBANIDËVE

Shyqyri Aliaj*

Trajtohet ecuria e regjimit tektonik në zonat e jashtme të Albanideve, nga tektonika në tërheqje deri në tektonikën në shtypje, që e kthen pellgun sedimentar në një zonë të rudhosur. Jepen shembuj të shkëputjeve normale sinsedimentare (në prerien e zonës Jonike e të Krastë-Cukalit), treguese të regjimit në tërheqje horizontale. Shkëputjet e vjetra normale kthehen në lartrrëshqitje-mbihypje në fazën shtypëse. Në shembullin e zonës së Kurveleshit jepet modeli i formimit të deformacioneve shtypëse. Kallëzohet faktori kontrollues i shkëputjeve të lashta në formimin e rrudhave të mëdha. Paraqitet shkurt kronologjia e deformacioneve paleo-tektonike të zonës Jonike në shembullin e rajonit Patos-Amonicë, të studiuar me metodën mikrotektonike.

HYRJE

Në këtë shkrim autori, duke u mbështetur në të dhënat faktike të grumbulluara prej tij e studiuësve të tjerë, në studimin mikrotektonik dhe nga deshifrimi i fotografive të bëra nga sateliti për Shqipërinë, trajton disa çështje themelore që piketojnë ecurinë e zhvillimit struktural të zonave të jashtëme të Albanideve deri sa kthehen në strukturë të rrudhosur.

Trajtohen këto çështje themelore të evolucionit struktural të zonave të jashtëme të vendit tonë:

1. Shkëputjet normale sinsedimentare në prerien e zonave të jashtëme dhe tektonika në tërheqje;
2. Kthimi i shkëputjeve normale të lashta në lartrrëshqitje deri mbihypje nga lëvizjet shtypëse dhe roli kontrollues i tyre në formimin e rrudhave të mëdha,

* Qendra Sizmologjike në Tiranë

(2) pas burdigalianit, në helvecian — *periudha e shkurtër (faza) e deformacioneve në shtypje*, që krijoi strukturat e mëdha jonike (rrudhat e lartrrëshqitje-mbihypjet).

Shkëputjet normale sinsedimentare, që ndajnë preriet e plota me ato me pushim në sedimentim pas liasit të mesëm, çojnë në copëtimin herst-grabenor të basenit jonik të sedimentimit dhe kushtëzojnë ndryshimet në faciet e trashësitë e depozitimeve jurasike të poshtme e të mesme; ky copëtim shënon riftëzimin kontinental, që paraprin, hapien e oqeanit të Tetisit dhe krijon buzën jugore të tij.

Si formacioni karbonatik ashtu edhe ai i flishor janë kapur nga deformacionet shtypëse pas burdigalianit (langian). Faza shtypëse pasburdigaliane e kthen basenin sedimentar jonik në një zonë të rrudhosur, duke krijuar rrudhat e mëdha e lartrrëshqitje-mbihypjet; shkëputjet e mëdha normale të lashta kthehen në lartrrëshqitje-mbihypje për llogari të lëvizjeve shtypëse. Rrudhat e krijuara deformohen mandej gjatë fazave shtypëse të etapës neotektonike (3).

Një ecuri e tillë e evolucionit struktural përshtatet mirë me të dhënat e tektonikës së pillakave për brezin alpin mesdhetar.

L I T E R A T U R A

1. Aliaj Sh., Kondo A., — Skicë mbi paleogjeografinë e strukturave Jonike. Bul UT, ser. shk. nat, 3, 1971.
2. Aliaj Sh., — Sizmotektonika dhe kriteret gjeologjike të sizmicitetit të Shqipërisë. Disertacion, 1979.
3. Aliaj Sh., Mehillka Ll., Sylari V., — Studimi eksperimental mikrotektonik i rajonit Patos-Amonicë. Fondi i institutit Gjeologjik të Naftës, 1986.
4. Dalipi H., — Mbi pushimet stratigrafike të serisë karbonatike të zonës Jonike. Përmbledhje studimesh, 2, 1979.
5. Dalipi H., — Pushimet stratigrafike në zonat tektonike të Albanideve të Jashtme dhe interpretimi i tyre paleogjeografik. Bul. Nafta dhe Gazi, 2, 1983.
6. Glangeaud L., 1944 — Cituar sipas J. Goguel, 1965-Traite de Tectonique.
7. — Harta Gjeologjike e Shqipërisë në shkallë 1 : 2000.000 Tiranë, 1983.
8. Kanani J., — Mospërputhje stratigrafike në rajonin e Bogazit dhe damarët sedimentarë që lidhen me të. Përmbledhje studimesh, 3, 1973.
9. Kanani J., — Litologjia dhe kushtet e sedimentimit të depozitimeve të jurasikut të poshtëm në zonën Jonike Disertacion, 1978.
10. Kanani J., — Kushtet e sedimentimit dhe evolucionit paleogjeografik i pellgut gjatë Jurasikut të hershëm në zonën Jonike. Bul. Shk. Gjeologjike, 4, 1983.
11. Kondo A., — Mbi qenien e strukturave jonike qysh në jurasikun e hershëm, dhe zhvillimin e tyre nënujor. Bul, UT, ser. shk. nat, 3, 1970.
12. Meko Z. etj., — Studim mbi gjeologjinë, çarshmërinë dhe naftëgazmbajtjen e strukturës së Kremenarës. Fakulteti Gjeologji-Miniera, 1967.
13. Nika Th., — Mendime mbi egzistencën e pushimeve stratigrafike jurasike në zonën Jonike. Përmbledhje studimesh, 3, 1971.,
14. Patzelt G., 1968 — Zur Geosynklinalen Wicklung und Tektonik der AuBeren Helleniden: Die Ionische Zone in Albanien. Reports of 23 Inter. Geol. Congres, Proc, of Section 3, Orogenic Belts.
15. Serjani A., Ylli L., — Rreth përkatësisë stratigrafike të horizontit fosfatik të kretakut në zonë Jonike Bul. Shken. Gjeol., 4, 1984.

16. **Shehu V., Kondo A., etj.** — Ndërtimi gjeologjik i rajonit të Lisnës, Përmbledhje studimesh, 4, 1966.
17. **Xhomo A., Kondo A., Papa A., etj.** — Transgresioni i titonian-neokomianit në zonën Jonike. Përmbledhje studimesh, 9-10, 1968.

Dorëzuar në redaksi në dhjetor 1986.

Summary

ON SOME FUNDAMENTAL ASPECTS OF THE STRUCTURAL EVOLUTION OF OUTER ZONES OF ALBANIDES

Based on the data drawn by the author and the others as regards the micro-tectonic study and the deciphering of photos by satellite for Albania, is treated the development of tectonic regimen in outer zones of Albanides — from the tectonics in tension which founds and faults the large ancient units (trenches and ridges), to the tectonic in compression, which transforms the sedimentary basin to a folded zone.

Several cases of the normal sinsedimentary faults both in Jurassic-Cretaceous and Oligocene — Lower Miocene deposits of the Jonian zone, as well as in Triassic-Jurassic sequence of the Krasta-Cukali zone, are given here. The normal faults are formed by the regimen in horizontal tension. The ancient normal faults are transformed to reverse fault — overthrusts by the compressional movements.

In the example of the Kurveleshi zone is given the model of the formation of the compressional deformations (of folds, reverse faults-overthrusts and tensions). The controlling factor of the ancient faults for the formation of large folds is shown.

The article gives the cronology of the paleotectonic deformations of the Jonian zone by the example of Patos — Amonicë region studied by the micro-tectonic method:

(1) From the Upper Triassic to Burdigalian — a long period of deformations in tention, simultaneously with the accumulation of the carbonaceous and flyschoidal deposits, giving horst-graben structures.

(2) After Burdigalian (Langhian) continues a short period of the deformation in compression, which changes the Jonian sedimentary basin to a folded zone, forming thus large folds and reverse faults-overthrusts.

Such a phenomenon of the structural evolution is well-adapted to the data of the plate tectonics for the Mediterranean alpine belt.

Fig. 1. — Liassic horst of Bençë with ESE extention (the normal sinsedimentary faults divide full sections from that with break in sedimentation).

Fig. 2a. — Normal sinsedimentary faults in Lefterohor (Delvinë) with near eastern extention, create horst-graben structures in Mali i Gjërë.

Fig. 2b. — Normal sinsedimentary fault with NW extention along Lefterohor-Qafa e Sopotit road (Delvinë).

Fig. 3. — Overthrust towards NE in Gusmar (Tepelenë).

Fig. 4 — Sinsedimentary horst of Gusmar during Late Cretaceous (Coniacian).
1. Pelagic limestones, 2. Pelagic limestones with rare phosphorite bands;
3. Massive phosphorites; 4. Dense banded phosphorites.

Fig. 5. — Normal sinsedimentary faults in Upper Cretaceous phosphorite — bearing limestones (Kremenarë).

- Fig. 6.** — Jurassic — Cretaceous faults in Vadejë reactivated in Eocene (According to the photo of Shehu V., 1966).
- Fig. 7.** — Jurassic — Cretaceous normal sinsedimentary fault in Vadejë (Shkodër).
- Fig. 8a.** — Sinsedimentary graben in sandstone deposits of Aquitanian in Mollaj (Fier).
- Fig. 8b.** — Normal sinsedimentary fault in Burdigalian of Drenova (Ballsh).
- Fig. 9.** — Normal faults and the axes of main normal stresses.
- Fig. 10.** — The model of formation of compressional deformation in the example of the Kurveleshi zone: A. In the end of the periode of the tectonic in tension (Burdigalian): normal faults, horizontal layers, B. Recent situation with the folds and faults (reverse faults, overthrusts and tensions).
- Fig. 11.** — Photosatelite lineaments for the Jonian zone.
- Fig. 12.** — Structures of the Berati belt and the axis of the compression G_1 (black arrow).
- Fig. 13.** — Anticline chain of Dajti and the axis of the compression σ_1 (interpretation by photosatelite).
- Fig. 14.** — The table of the paleotectonic deformations in Patos-Amonicë region.

SKEMA E ZHVILLIMIT PALEOGJEOGRAFIK E GJEOTEKTONIK TË ALBANIDEVE TË BRENDSHME GJATË TRIASIKUT E JURASIKUT.

Alaudin Kodra*

Disa periudha e faza të rëndësishme shënojnë zhvillimin paleogjeografik e tektonik të Albanideve të brendshme gjatë Triasikut dhe Jurasikut. Gjatë Ladianianit të vonshëm deri në Liasik të mesëm u diferencuan qartë sektorë të gjerë të Albanideve. veçanërisht në rajonet qendrore e lindore. Gjatë Jurasikut, në rajonet qendrore e lindore të Albanideve ka ndodhur thellimi i përgjithshëm i basenit dhe hapja e kores oqeanike. Gjatë Jurasiko-Kretakut ka patur vend tektogjeneza shumë fazore që çoi në vendosjen tektonike (për obduksion) të ofioliteve që u shoqërua me metamorfizimin dhe u pasua me formimin e flishit të hershëm dhe ngritjen e rajoneve lindore të Albanideve.



Vitet e fundit në kuadrin e studimeve krahinore të kryera nga gjeologët tanë (5,11,6,30,1,7,8,9,10,12,13,14,15,17,18,19,20,22,23,24,25,26,27, 28,29, etj.) janë mbledhur të dhëna të reja gjeologjike që qartësojnë më mirë strukturën e Albanideve dhe që ndihmojnë për një kuptim më të drejt të strukturës së madhe Dinarido-Albanido-Helenide, duke përfshirë këtu edhe vendin e formimit të ofioliteve dhe vendosjen gjeotektonike të tyre. Studimet stratigrafike, rilevimet gjeologjike e gjeofizike në shkallë të ndryshme, studimet petrologjike, sedimentologjike, etj, si dhe punimet e shumta të kërkim-zbulimit të mineraleve të dobishme, kanë bërë të mundur të sqarohet në shkallë të kënaqëshme si tipi i litosferës kontinentale e oqeanike të Albanideve ashtu edhe mekanizimi, gjeodinamik i formimit të strukturave.

Në këtë shkrim do të trajtojmë periudhat e fazat kryesore të zhvillimit paleogjeografik-tektonik të Albanideve të brendshme gjatë Triasikut e Jurasikut.

Fillimi i historisë alpine njihet mirë në rajonet lindore të Albanideve. Sedimentet konglomerato-ranorike të permian-verfenianit (seria

* Ministria e Industrisë dhe Minierave në Tiranë.

P Ë R F U N D I M E

1. Gjatë ladinianit të vonshëm deri në liasikun e hershëm — të mesëm në rajonet qendrore e lindore të Albanideve ka ndodhur një diferencim i theksuar i basenit në një sërë hullish e kurrizoresh, të cilat gjatë hapjes oqeanike jurasike u homogjenizuan në një hulli të gjerë. Zona e Korabit gjatë zhvillimit të saj paleogeografik triasiko-jurasik nuk ka përfaqësuar kurrizore por një hulli në lindje të kurrizores së Gjalllicës. Edhe zona e Mirditës gjatë asaj kohe nuk ka përfaqësuar një shpat lidhës midis hullisë së Krastë-Cukalit në perëndim dhe «kurrizores» së Korabit në lindje, por një kompleks kurrizoresh dhe hullish, që në përgjithësi u homogjenizuan në një hulli të gjerë gjatë hapjes oqeanike jurasike.

2. Ofiolitet e zonës së Mirditës përfaqësojnë shfaqje të kores oqeanike gjatë jurasikut (kryesisht të vonshëm), të hapur në pjesën lindore të hullisë së Qerret-Miliskasë, në perëndim të kurrizores së Gjalllicës.

3. Në pamjen më krahinore mund të përfundojmë se Dinarido-Albanido-Helenidet e brendshme tregojnë zhvillim paleogeografik e tektonik kompleks në kohë e hapësirë, ku si themelore mund të shënohet që një periudhë zgjerimi oqeanik e para titonianit të vonshëm (dhe pas liasike) në dy basene të veçuara (të Mirditës e të Vardarit) është ndjekur nga fazat e rëndësishme tektogjenetike jurasiko-kretake dhe të terciarit. Gjatë periudhës së kompresionit kemi mbivendosjen e ofioliteve gjatë jurasikut të vonshëm mbi buzët kontinentale përkatëse (të zonës së Mirditës dhe të Vardarit) dhe metamorfizmin që u pasua me formimin e flishit të hershëm konglo-brekçor-mergelor jurasiko-kretak.

L I T E R A T U R A

1. Aliaj Sh. — Sizmotekonika dhe kriteret gjeologjike të sizmitetit në Shqipëri. Disertacion. Tiranë, 1979.
2. Çili P. — Ndërtimi i brendshëm dhe zhvillimi i përgjithshëm i katit të poshtëm struktural të zonës së Mirditës. Bul. Shk. Nat. Nr. 3, Tiranë, 1971.
3. Dede S. — Mbi karakterin impulsiv të intruzioneve të magmës ultrabazike. Përmb. Stud. Nr. 2. Tiranë, 1967.
4. Dede S. — Disa të dhëna mbi problemin e moshës e të vendit hapësitor të ultrabazikëve të truallit të Shqipërisë. Përmb. Stud. Nr. 2. Tiranë, 1967.
5. Harta gjeologjike e R.P.S.SH. në shk. 1 : 200.000. 1982.
6. Harta tektonike e R.P.S.SH. në shk. 1 : 200.000, 1985.
7. Gjata K. — Petrologjia dhe perspektiva e nikelit sulfur dhe sulfureve të tjera të kompleksit gabroperidotitik të Mirditës perëndimore. Disertacion. Tiranë, 1980.
8. Gjata K., Kodra A., Mustafa F., Zhukri E., — Marëdhëniet intruzive të shkëmbinjve ultrabazikë me shkëmbinj të karbonatikë Triasiko-Liasikë në pjesët anësore të zonës së Mirditës dhe në zonën e Korabit. Bul. Shk. Gjeol. Nr. 4 Tiranë, 1985.
9. Gjata K., Kodra A., Mustafa F., Zhukri E., Aliaj Q., Lika O., — Studim tematik dhe punime kërkimi për sqarimin e perspektivës për minerale të rralla në vendin tonë. Tiranë, 1986.
10. Gjata Th., Kici V., Marku D., — Stratigrafia e depozitimeve mesozoike. Tiranë, 1985.
11. Gjeologjia e Shqipërisë. Tiranë, 1982.
12. Kodra A., — Mbi moshën jurasike të formacionit vullkanogjeno-sedimentarë të zonës së Mirditës. Përmb. Stud. Nr. 1. Tiranë, 1976.
13. Kodra A., Delaj E., — Të dhëna të reja mbi ndërtimin gjeologjik të rajonit të Poravit. Përmb. Stud. Nr. 4 Tiranë, 1976.

- 14. Kodra A., Shehu B., Goci L., Selimi B., — Gjeologjia e pjesës veriore të njësisë së Gjallicës. Përmb. Stud. Nr. 3. Tiranë, 1980.
15. Kodra A., Gjata K., — Ofiolitet në kuadrin e zhvillimit gjeotektonik të Albanideve të brendshme Bul. Shk. Gjeol. Nr. 2. Tiranë, 1982.
16. Kodra A. — Shkëmbinjtë jurasikë dhe jurasiko-kretak në rajonet verilindore të Albanideve. Përmb. Stud. Nr. 3, 1981.
17. Kodra A. — Gjeologjia dhe perspektiva e mineraleve të dobishme në rajonin Resk-Shishtavec. Disertacion. Tiranë, 1986.
18. Langora Ll., Bushati S., Likaj N., — Disa mendime për trajtën e përhapjes së ofioliteve të Albanideve Bul. Shk. Gjeol. Nr. 4, Tiranë, 1983.
19. Melo V. — Përhapja e flisheve në gjuhën flishore të Peshkopi Labinotit dhe mendime lidhur me vendosjen paleogeografike e tektonike të saj. Bul., Shk. Gjeol. Nr. 2. Tiranë, 1982.
20. Ndojaj J., — Mbi disa probleme të magmatizmit në vendin tonë. Bul. U.T. Ser. Shk., Nat. Nr. 2 Tiranë, 1963.
21. Ndojaja I.Gj., Kote Dh. Gjata K., Vranaj A., Zeqja K; Marëdhëniet e shkëmbinjve të bashkësisë ofiolitike me gëlqerorët në krahun lindor të Lurë-Bulqizës Bul. U.T. Ser. Shk. Nat. Nr. 3. Tiranë, 1964.
22. Petro Th., — Fakte të reja për gjeologjinë e rajonit Shtyllë-Treskë-Qarr. Përmb. Stud. Nr. 1 Tiranë, 1986.
23. Peza L.H. etj. — Stratigrafia e depozitimeve kretake të zonës së Mirditës. Tiranë, 1985.
24. Pulaj H., Godroli M., — Punime kërkim-rilevimi në shk. 1 : 25000 në rajonin e Shpatit. Tiranë, 1984.
25. Shallo M., Gjata Th., Vranaj A., — Përfytyrime të reja për gjeologjinë e Albanideve lindore nën shembullin e rajonit Martanesh-Çermenikë-Klenjë. Përmb. Stud. Nr. 2 Tiranë, 1980.
26. Shallo M., Gjata Th., Vranaj A., Theodhori P., — Gjeologjia e rajonit të Korçë-Kolonjë-Leskovik. Bul. Shk. Gjeol. Nr. Tiranë, 1980.
27. Shallo M., — Petrologjia e shkëmbinjve magmatikë të Mirditës qendrore dhe mineralizimi sulfur lidhur me ta. Disertacion. Tiranë, 1980.
28. Shehu R., etj. — Shënime sqaruese për hartën tektonike të RPSSH në shkallë 1 : 2500000 Përmb. Stud. Nr. 4, Tiranë, 1980.
29. Shehu V., — Tiparet strukturoro-faciale të luginës së lumit Drin dhe vlerësimi inxhiniero-gjeologjik i tyre për ndërtimin e H/C të Komanit. Disertacion. Tiranë, 1978.
30. Tektonika e Shqipërisë. Tekst shpjegues i hartës tektonike të RPSSH në shk. 1 : 200.000 Tiranë 1985.
31. Aubouin J., 1973 — Des tectoniques superposées et de leur signification par rapport aux modèles géophysiques: l'exemple des Dinarides; paleotectonique, tectonique, tarditectonique, neotectoniques B.S.G.F., (7^e), 15, Paris.
32. Aubouin J., (1977) — Breve présentation de la géologie de la Grèce. B.S.G.F. (7^e), 1, XIX, Paris.
33. Beblen J., Ohnesteter D., Ohnensteter M., et Vergely P. (1980). — Diversity of the Greek ophiolites; Birth of oceanic bassins in transcurrent systems. Ofioliti, sp. issue, vol. 2. Firenze.
34. Biju Duval B et Dercourt J (1980) — Les bassins de la méditerranée orientale représente-ils les restes d'un domaine océanique la Mesogée, ouvert au Mésozoïque et distinct de la Tethys? B.S.G.F. (7^e) XII, Paris.
35. Billot G., (1977) — Modeles actualistiques des Héléniides. B.S.G.F. (7^e), XIX, 1, Paris.
36. Blanchet R., (1976), — Bassins marginaux et Tethys Alpine de la marge continentale au domaine océanique dans les Dinarides. Simp. Int. Str., Split. Yougoslavie.
37. Cadet J.P. Bonneau M., Charvet J., Durr S., Elter P., Ferriere Scandone P., Thiebault F. (1980). — Les chaines de la Méditerranée moyenne et orientale 26° (G.I., Coll. C-5 Mem B.R.G.M., 115.
38. Dercourt I. Zonenshain L., Ricou L-E., Kazmin V., Lë Pichon X Kniper A., Grandjacquet C., Sborshchikov I., Boulou J., Sorokhtin O., Geysant J., Lepvrier C., Biju-Duval B., Sibnet J.C. Savostin L., Westphal M., Laurer J-P (1985). Présentation de 9 cartes paléogéographiques au 1/20.000.000^e s'étendant de l'Atlantique au Pamir pour la période du Lias à l'Actuel. B.S.G.F. (8) t. 1, n° 5, Paris.

39. Kosmat E., (1922) — Geologie der zentralen Balkan Halbinsel Die kriegasschae glapza.
40. Mercier I., Vergely P., (1977) — La zone d'Almopias B.S.G.F. (7e) XIX No 1, 1977 Paris.
41. Mercier I., Bebien J., (1977) Les zones de Paikon et de Peonia B.S.G.F. (7e), Nr. 1, 1977. Paris.
42. Vergely P. (1984). — Tectonique des ophiolites dans les Héliénides internes (déformations, métamorphismes et phénomènes sédimentaires). Conséquences sur l'évolution des régions Tethysiennes occidentales. Paris.

Dorëzuar në redaksi në qershor 1987.

Summary

SCHEME OF THE PALEOGEOGRAPHICAL AND GEOTECTONIC DEVELOPMENT OF INNER ALBANIDES DURING THE TRIASSIC AND JURASSIC

The following important periods and stages of the paleogeographical and tectonic development of Inner Albanides during the Triassic and Jurassic can be distinguished:

- During the Late Ladinian — Middle Liassic vast sectors of Albanides, especially the central and western ones, have been clearly differentiated.
- During the Jurassic in the central — eastern regions of Albanides occur the general deepening of the basin and the opening of the oceanic crust.
- During Jurassic — Cretaceous has been in action the multiphaseous tectogenesis, which led to the tectonic (for obduction) setting of ophiolites accompanied with the metamorphism and passed by the formation of Early Flysch and the uplifting of eastern regions of Albanides.

Fig. 1. Sketch of the stratigraphic correlation of Triassic-Jurassic deposits of Inner Albanides.

1. Paleozoic schists; 2. a. conglomerates — sandstones; b. sandstones, marly limestones, marly schists; 3. a. dolomites and dolomitic limestones; b. nodular limestones with ammonites; 4. Thin-bedded limestones with cherts and tuffs; 5. Thick-bedded stromatolitic limestones with megalodonts; 6. Marly limestones with *Involutina liassica* and *Protoglobigerina*; 7. Radiolarites; 8. Volcano-sedimentary rocks; a. of Verfenian; b. of Anisian; c. of Upper Jurassic.

Fig. 2. Paleogeographical sketch of Albanides and of the most eastern regions during the Late Ladinian-Early Liassic.

Fig. 3. Paleogeographical sketch of Albanides and of the most eastern regions during Late Tithonian-Berriasian.

Mineralet e dobishme

Metalogjenia e thyerjeve tërthore të Albanideve

— Andon Grazhdani* —

Trajtohet karakteri i tërthoreve, mineralizimi që lidhet me to dhe drejtimet e zhvillimit të brezave xeherore.

Studimet gjeotektonike (1, 7) të kryera vitet e fundit në vendin tonë, të shoqëruara nga studimet e fushave të sforcimeve tektonike të sotme, nëpërmjet evidencimit të mekanizmit të vatrave të tërmeteve (15, 16) dhe punimet gravimetrike mbi përbërjen dhe thellësinë e kores së Tokës në truallin tonë (16) kanë sjellë të dhëna praktike mbi zhvillimin e ndërtimit gjeologjik të trojeve tona në kuadrin e përgjithshëm të zhvillimit bllokor të hapjes dhe të mbylljes së kores oqeanike të Tetisit dhe të lidhjes me to të provincave dhe brezave metalogjenike.

Në Albanidet, zona Mirdita përfaqësohet nga shkëmbinjtë ofiolitike të hapjes së kores tokësore. Kjo zonë përshkohet nga tre thyerje tërthore paralel me drejtimin jugperëndim-verilindje: Shkodër-Pejë, Fier-Elbasan-Dibër-Shkup dhe Tepelenë-Korçë. Këto thyerje përshkojnë të gjitha zonat tektonike të Albanideve të brendshme e të jashtme, zonën e Pelagoneve duke ndërprerë edhe zonën e Vardarit me masivet Serbo-Maqedonas (23, 26).

Thyerjet kanë një zhvillim të madh jo vetëm në shtrirje, por edhe në rënie. Të dhënat e studimeve gravimetrike të bëra në vendin tonë (7) dhe studimet e ndryshme gjeofizike të bëra përtej kufijve tanë (26), tregojnë se në këto thyerje ka një fleksurë dhe një ndryshim të menjëhershme të thellësisë së tabanit të poshtëm të kores së Tokës. Ky fenomen është shumë i theksuar në thyerjet Shkodër-Pejë dhe Fier-Elbasan-Dibër-Shkup, ndërsa në thyerjen e tretë shprehet vetëm në rajonet e Korçës.

* Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minerave në Universitetin «Enver Hoxha».

thoreve me thyerjen gjatësore aktive edhe në ditët tona (16), që kalon midis ultësirave të brendshme, prej Korçë në Mokër-Librazhd, Burrel-Kashnjet. Edhe objekti i plumbit në Kir, takohet në nyjen e kthesës së mbihijjes së Alpeve në drejtim të jugut.

Formacionet e asbestit, talkut dhe magneziteve, lidhen me kumulatet ultrabazike. Të gjitha këto mineralizime ndodhen në buzët e masivëve ultrabazikë në afërsi të thyerjeve. Në këta sektorë, brenda brezave ndodhen objekte të rëndësishme dhe dallohen sheshe perspektive.

P Ë R F U N D I M E

Të gjitha zonat tektonike të Albanideve, përshkohen nga tre tërthore, me drejtim jugperëndim-verilindje. Këto tërthore vazhdojnë në lindje përtej kufijve të trojeve tona në zonën e Pelagoneve Vardarit me masivët Serbo-Maqedonase. Tërthoret emërtohen Shkodër-Pejë, Fier-Elbasan-Dibër-Shkup dhe Korçë-Tepelenë. Të dhënat e studimeve gjeologjiko-tektonike, gravimetrike dhe sizmike tregojnë se këto kalojnë në gjithë trashësinë e kores së Tokës duke u futur deri në mantelin e sipërm.

Për të tre thyerjet është karakteristik i njëjti tip mineralizimi i përbërë nga realgar-auripigment, cinabariti, fluoriti, bariti, galeniti, sfaleriti, arsenopiriti, etj. Me këto tërthore lidhen edhe mineralizimet e asbestit, talkut dhe magneziteve.

Kriteri kryesor që përcakton shpërndarjen dhe përqëndrimin e mineralizimit janë faktorët strukturorë, prishjet e rendeve të ndryshme. Mineralizimi ndërpret gjithë trashësinë e depozitimeve nga triasiku deri në paleogjen. Koha e formimit të tyre i përket nismës së etapave neotektonike.

Brenda çdo thyerje dallojmë dy breza xeherore të mbivënë, të cilët ndjekin zhvillimin në shtrirje të thyerjeve tërthore. Brezi i parë dhe më i gjërë përfaqësohet nga formacionet xeherore të Hg, As, F, Pb, Zn dhe Ba. Ndërsa brezi i dytë që ndjek konturet e shkëmbinjve ultrabazikë në afërsi të thyerjeve përfaqësohet nga mineralizimet e asbestit dhe magneziteve.

Në çdo brez xeheror në varësi të faktorëve kontrollues të mineralizimit dallojmë disa sheshe perspektive.

L I T E R A T U R A

1. Alia Sh. — Sizmotektonika dhe kriteret gjeologjike të sizmicitetit të Shqipërisë. Disertacion, 1979.
2. Bajo I. — Evaporitet e zonës Jonike, dukuritë diapirike të tyre dhe perspektiva e mineraleve të ngurta, në strukturat që formojnë ato. Disertacion, 1984.
3. Duro A., Duka V., Nikolla M. — Fluoriti në shkëmbinj të karbonatikë. Buletin i Shkencave Gjeologjike Nr. 2, 1984.
4. Grazhdani A. — Perspektiva e kërkimit të mineralizimit të zhivës në të dy anët e thyerjeve Shkodër-Tropojë. Disertacion, 1981.

5. **Grazhdani A., Tuzi H.** — Termometria e fluoritit. Referat në sesionin shkencor të Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave, 1985.
6. **Gjata K., Kodra A.** — Magmatizmi pasofiolitik jurasiko-kretak dhe ai më i ri mesataro-acid në vendin tonë. Buletini i Shkencave Gjeologjike Nr. 4, 1982.
7. Harta tektonike e RPSSH. Tiranë, 1985.
8. **Liko V.** Përbërja kimike, tipi i mineralit dhe veçoritë fiziko-mekanike të asbestit në shfaqjet e mineralizuara të rajonit të Gomsiqes. Përmbledhje Studimesh, Nr. 3, 1975.
9. **Ndoja I., Gj. Poga K.** — Problemi i asbestit të Pukës dhe i asbestit në përgjithësi në vendin tonë. Përmbledhje Studimesh Nr. 2, 1969.
10. **Ndoja I. Gj. Bakalli E., Gjata K.** — Mendime për mineralizimet polimetalore të vendit tonë. Përmbledhje Studimesh Nr. 4, 1972.
11. **Osmani N., Mullaj F.** — Disa të dhëna mbi mineralet shoqëruese të zonave asbestmbajtëse të vendit tonë. Përmbledhje Studimesh Nr. 2, 1975.
12. **Premti I.** Disa veçori të lokalizimit të arsenikut në një pikë të mineralizuar të rrethit të Dibrës. Përmbledhje Studimesh Nr. 1, 1971.
13. **Sinoimeri Z., Ostrosi B., Grazhdani A. etj.** — Të dhëna paraprake mbi tipet e mineralizimit të zhivës në një rajon të pjesës veriore të zonës tektonike të Mirditës. Përmbledhje Studimesh Nr. 2, 1978.
14. **Sinoimeri Z., Buda V., Turku A. etj.** — Studim përgjithësues mbi disa tipe të mineralizimit (polisulfure) në vendin tonë. Tiranë, 1981.
15. **Sulstarova E., Koçiaj S., Aliaj Sh.** — Rajonizimi sizmologjik i RPSSH në shkallë 1 : 500 000. Tiranë, 1978.
16. **Sulstarova E.** Mekanizmi i vatrave të tërmeteve dhe fusha e sforcimeve tektonike të sotme në Shqipëri. Disertacion për gradën Doktor i Shkencave, Tiranë, 1986.
17. **Shallo M.** Mbi problemin e magmatizmit acid në Shqipëri Buletini USHT Seria e Shk. Natyrore Nr. 4, Tiranë, 1970.
18. **Shkodrani N.** Aspekte të talkut dhe gurtalkut në zonën e Mirditës. Përmbledhje Studimesh Nr. 2, 1973.
19. **Shkodrani N.** Kushtet e formimit të asbestit e të talkut, ligjësitë e përhapjes dhe perspektivat e tyre në vendin tonë. Disertacion, Tiranë, 1981.
20. **Tërshana A.** Petrologjia dhe matelogenia e kompleksit gabro-peridotit në rajonin Kashnjet-Qelzë Disertacion, 1982.
21. **Theodhori P., Bushati S., Pirdeni A.** — Stratigrafia e depozitimeve mesozoike të zonës së Cukalit dhe disa probleme të mineralmbajtjes. Tiranë, 1978.
22. **Vaso P.** Mbi mineralizimin e dausonitit të rajonit të Komanit. Përmbledhje Studimesh Nr. 2, 1977.
23. **Arsovski M., Ivanov T.** — Neotectonica magmatism and metallogeny on the territory of Yugoslavia, 1977.
24. **Hutchison Ch. S.** Economic Deposits and the Tectonic Setting, 1983.
25. **Mitchell A.H., Garson M.S.** — Globalnaja, tektoničeskaja pozicija mineralnih mestorozhdeni, 1984.
26. **Janković S.** Major Alpin ore deposits and metallogenic units in the NE Mediterranean and concepts of plates tectonics., 1977.

Summary

METALLOGENY OF THE TRANSVERSAL FAULTS IN ALBANIDES

New data on the blocky development and its relation with the metallogenic belts, have been obtained by means of the geotectonic studies accompanied with the studies of the fields of recent contractions, as well as with the gravimetric and seismic data, on the composition in depth of the Earth's crust.

The Albanides are intersected by three parallel transversals: Shkodër-Pejë, Fier-Elbasan-Dibër-Shkup and, Tepelenë-Korçë, with south-west-northeastern direction. These three transversals penetrate entire the Earth's crust, reaching up to the mantle. The Shkodër-Pejë fault, with its horizontal movement retains the characteristics of a transforming fault. No horizontal movements exist in two other faults, both, in the Mirdita and other zones. The same type of mineralization is characteristic of these three transversals. The realgar-auripigmentum, cinnabarite, fluorite, barite, chalcite, sphaalerite and galenite are found in them. Only the mineralizations of asbestous and magnesite are encountered in these transversals.

The structural and lithological factors (from Triassic-to Paleogene) constitute the main criteria which determine the spreading out and concentration of mineralization. The forming of mineralizations is linked with the beginning of the neotectonic stages of post-Middle Miocene.

Two ore belts have been distinguished within each fault. Hg, As, F, Pb, Zn and Ba is the first belt. The second one follows the outlines of the ultrabasic rocks close to the faults, in asbestous, magnesite and talc.

Fig. 1. Sketch of the development of transversal faults for different tectonic zones.

Fig. 2. Sketch of mineralization and metallogenic units of the faults of Albanides.

MAREDHENIET MIDIS PRODHIMEVE LATERITIKE DHE FORMACIONEVE QYMYRBAJTËSE TË ALBANIDEVE

E. Pumo, B. Ostrosi (*)

Parashtrohen disa dukuri të vendosjes së lateriteve hekur-nike-lore, të boksiteve dhe të depozitimeve qymyrmajtëse si dhe shkaqet që kushtëzojnë marrëdhëniet kohore e hapësinore ndër-mjet tyre në Albanide, kryesisht në zonën tektonike Mirdita.

H Y R J E

Vite më parë krahas dukurive mbi prodhimet lateritike dhe rrugëve të formimit të tyre, jemi ndeshur edhe me praninë e depozitimeve qymyrmajtëse ose të shfaqjeve qymyrore në afërsi të vendburimeve të xeherorëve të hekur-nikelit dhe të boksiteve.

Disa autorë kanë vënë në dukje gjithashtu praninë e serive qymyrmajtëse, dhe të shenjave të qymyrformimit pranë vendburimeve lateritike ose të prodhimeve të tjetërimit lateritik (1,6,8,11,13). Shenja qymyrëzimi kemi takuar edhe brenda prodhimeve lateritike të Ura e Lumës në afërsi të Kukësit. Ato janë përshkruar edhe në literaturën gjeologjike të huaj.

Prania e serive ose e grumbullimeve qymyrore mbi vendburimet lateritike të hekur-nikelit, të boksiteve ose pranë tyre, nuk është një rastësi por një dukuri që lidhet ngushtë me zhvillimin gjeotektonik të strukturave të rendeve të ndryshme të kores tokësore, dukuri këto që hedhin dritë për të mbështetur e zhvilluar më tej ligjësitë e formimit dhe të përhapjes së formacioneve ekzogjene dhe të vendburimeve të mineraleve të dobishme që lidhen me to.

Më poshtë do të parashtrojmë disa raste të këtyre dukurive në Albanidet, kryesisht në zonën tektonike Mirdita, marrëdhëniet hapësinore e kohore të vendburimeve lateritike dhe të serive qymyrmajtëse, përgjithësimet dhe rekomandimet që rrjedhin prej tyre.

(*) Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave në UT «Enver Hoxha».

nike dhe mbyllet me qymyret e vendburimit Mborje-Drenovë dhe me seritë qymyrmbytëse të Alarupit, Sul Kuçit etj.

Ndërsa në evolucionin metalogjenik të zonave të jashtëme, vërehet një lidhje më e dobët ndërmjet boksiteve dhe rreshpeve qymyrore. Ajo ka kaluar nëpër disa faza metalogjenike (fig. 4, 5).

1) Faza më e hershme është ajo kimerike e vonshme që karakterizohet nga boksitët të cilësisë së lartë, të mbuluara drejtpërdrejt nga një pako kalimtare argjilore me ndërshtresa të holla të rreshpeve djegëse (zona e alpeve Verilindore).

2) Faza kimerike e re, në Alpet veriperëndimore që përfaqësohet nga boksitet argjilore pa rëndësi industriale në jurasikun e sipërm të shoqëruara gjithashtu me rreshpe të dobëta qymyrore.

3) Fazat më të reja i përkasin zonës Kruja, ku dallohet faza metalogjenike laramike deri në ato pirenease e save që përfshin vendburimet dhe mineralizimet e njohura që nga vargmalet Krujë-Dajt e deri në Gramsh. Përgjithësisht në to shfaqet një lidhje e dobët e formacioneve xeherore boksitmbajtëse me formacionet qymyrore që janë pak të zhvilluara dhe vendosen në depozitimet molasike të neogjenit, me mospajtim këndor me depozitimet karbonatike të kretakut të sipërm.

Duke shikuar me kujdes këto lidhje në vertikalisht dhe horizontalitet mund të vijmë në përfundim se në historinë e zhvillimit të kores tokësore ka pasur periudha në kushte klimatike që kanë favorizuar gjerësisht formimin e lateriteve nikelore dhe hekurore e pastaj të boksiteve, të cilat, më vonë janë pasuar nga një periudhë që kanë nxjerrë në plan të parë formimin e serive qymyrmbytëse.

P Ë R F U N D I M E

1. Ndërrimi i shpejtë i regjimit regresiv me atë transgresiv është gjithmonë me perspektivë për prerje facialo-metalogjenike të rradhës së formimeve të kores së tjetërimit të hekur-nikelit, të boksiteve dhe formacioneve qymyrore me rëndësi industriale si në zonat e jashtëme e veçanërisht në zonat e brendëshme facialo-strukturore të vendit tonë.

2. Vazhdimi për një kohë të gjatë i regjimit transgresiv i shprehur me depozitime të fuqishme karbonatike dhe i ndërrimit me periudha të shkurtra e të rralla regresive, nuk paraqitet perspektive nga ana facialo-metalogjenike.

3. Në dritën e kësaj lidhjeje, e cila me siguri do të pasurohet me të dhëna të reja në të ardhmen, do të ndihmohen kërkimet gjeologjike, duke zgjeruar më tej sheshet e përhapjes së prodhimeve lateritike të serive qymyrmbytëse.

L I T E R A T U R A

1. **Arkaxhiu F.** — Gjeologjia paleogjeografia dhe kushtet e formimit të xeherorëve hekur-nikelorë të rajonit Radokal-Katiel Bul. i Shk. Gjeol. Nr. 3 1985.
2. **Dimo Li. etj.** — Rreth kushteve të formimit dhe perspektivës qymyrmbytëse të depozitimeve molasike të ultësirës së Korçës. Bul. i Shk. Gjeol. Nr. 4 1982.
3. **Çina A. Tashko A.** — Një krahasim gjeokimik për masivët ultrabazikë të Bulizës e të Gomsiqes (ofiolitet e Albanideve) Bul. Shk. Gjeol. Nr. 9, 1986.

4. — Harta gjeologjike e Shqipërisë, 1983.
5. Guranjaku S. — Boksidmbajtja e Shqipërisë dhe perspektiva e mëtejshme e njohjes së saj. Disertacion, 1985.
6. Molla I. — Të dhëna të reja për gjeologjinë dhe veçoritë e ndodhjes së prodhimeve të kores së tjetërsimit në rajonin Skroskë-Katiel. Bul. i Shk. Gjeol. Nr. 1, 1985.
7. Pashko P. — Biostratigrafia, molusqet dhe nomenklatura e depozitimeve oligocene të Moravës. Përmb. Stud. Nr. 3 1977.
8. Petro Th., Dodona E. — Vlera litofaciale dhe biostratigrafike e horizontit të gëlqerorëve korallorë në strukturën molasike të Moravës dhe të Gorrë-Mokrës Përmb. Stud. Nr. 3, 1976.
9. Peza L. Pumo E. — Disa njohuri mbi ndërtimin gjeologjik të strukturës sinklinale të Mokrës. Bul. USHT Ser. Shkenc. Nat. Nr. 1 1958.
10. Ostrosi B., Durmishi Ç. — Vendburimet e mineraleve të dobishme dhe kërkimi i tyre (Gjeologjia e vendburimeve qymyrore) U.T. «Enver Hoxha». 1987.
11. Ostrosi B., — Vendburimet minerale të dobishme dhe kërkimi i tyre. Nr. 2. Botimi i UT. «Enver Hoxha», 1986.
12. Pumo E. — Ligjshmëria e përhapjes së vendburimeve të hekurnikelit në Shqipërinë Qendrore-Lindore dhe drejtimi i mëtejshëm i punimeve gjeologjike. Disertacion, 1962.
13. Pumo E. — Disa njohuri mbi vendburimet e plumb-zinkut të nikelit-silikat, të boksideve, të magneziteve dhe të linjiteve të krahinës së Kosovës. Në botimin: Probleme të gjeologjisë së vendburimeve të mineraleve të dobishme dhe metodat e kërkimit 1974.
